



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 1247/1 prot.

Tiranë më 3.8.2018

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”.

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.13270/1 Prot., datë 30.07.2018, në lidhje me Projektligjin “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, Zyra e Komisionerit vlerëson se nëpërmjet këtij projektakti synohet të realizohet përpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave personale të karakterit financiar dhe në këtë kuadër është e nevojshme që ky proces përpunimi të jetë konform parashikimeve të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Pas analizimit të përmbajtjes së Projektligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Për termin “Ofruesit e shërbimeve të palës së tretë”, përmendur në nenit 6, të parashikohet përkufizimi përkatës në nenin 3 “Përkufizimet”;
- Pas nenit 3, të shtohet një nen i ri me përmbajtje si vijon:
“Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të procesit të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Në nenin 5 të shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon:
“Institucionet financiare raportuese kanë detyrimin që përpara fillimit të procesit të raportimit, të informojnë “personat raportues” lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre personale në kuadër të procesit të raportimit pranë Autoritetit Kompetent, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Referuar paragrafit 1 të nenit 6, është e nevojshme që në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave (sanksionuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar) të vlerësohet

rast pas rasti dokumentacioni dhe informacioni që është i nevojshëm që t'ju vihet në dispozicion “ofruesit të shërbimeve të palës së tretë” ose institucioneve të tjera financiare, në mënyrë që niveli i aksesit të përputhet me qëllimin e përpunimit;

- Në pikën 2 të nenit 8 të kryen ndryshimet si vijon:
Të shtohet paragrafi “c” me përmbajtje: *“marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të këtij ligji”;*
- Në paragrafin “b” të parashikohet se çfarë ndodh me të dhënat pas përfundimit të këtij afati 5 vjeçar. Pra, nëse të dhënat arkivohen apo shkatërrohen, fshihen etj;
- Në nenin 12, pas pikës 1 të shtohet pika me përmbajtje si vijon:
“Çdo punonjës i Autoritetit Kompetent, Institucionit Financiar Raportues dhe çdo funksionar publik që ka akses në të dhëna personale që përpunohen në kuadër të këtij ligji, ka detyrimin që të nënshkruajë deklaratën e konfidencialitetit, e cila administrohet nga Institucioni përkatës në cilësinë e punëdhënësit”.

Për hartimin e “Deklaratës së Konfidencialitetit” sugjerojmë që të bazoheni në standardin e parashikuar në Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”, miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Me realizimin e këtyre rregullimeve, projektligji i ardhur për mendim do të konsiderohej në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

